



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 103 dt.29.07.1996

PER
DHENIEN E FOND KONSERVIMIT PER
NDERMARRJEN E GALANTERISE

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.29.07.1996, pasi shqyrtoi relacionin për dhënie fond konservimi për Nd.Galanterisë, mbështetur në VKM Nr.589, dt.16.10.1995, pika.7,

VENDOSI

1. Nd.Galanterisë ti jepet një fond monetar për financimin e pagës të komisionit të likujdimit, pagën e drejtorit, financierit dhe magazinjerit.
2. Kësaj ndërmarrje ti jepet një fond prej 30 mijë lekë për plotësimin e nevojave për dryna, llampa elektrike etj.
3. Fondet e dhëna të jenë në kontroll të Drejtorit Financës dhe Kontroll Revizionit dhe Sek. Prognozës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Fin.Kontroll-Revizionit dhe Sek.Prognozës.
5. Konservimi të fillojë sapo të miratohet platforma e privatizimit nga Ministria e Financave.

KRYETARI

BESNIK PETRELA